



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:279934
Datë: 24.01.2024
Numri i dokumentit: 05234052

C.nr.9344/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.H. nga P..., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. L.B. nga P..., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontestit kompensim për avancim në karrierë dhe zhvillim profesional dhe kompensim e inflacionit, jashtë seancës, me datë 22.01.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.H. nga P..., të cilën sipas autorizimit i përfaqëson Av. L.B. nga P..., ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të diferencës së papaguar në pagë në bazë të licencimit – gradimit për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 30.01.2023, t'ia paguaj 27% e pagës pazë (paga bazë është 421.00 €) e në total 61 muaj, të ia kompensojë shumën prej 3,376.35€, si dhe në emër të inflacionit për periudhën 01.01.2019 deri më 31.10.2022 në total për 46 muaj të t'ia kompensojë shumën prej 806.40€, apo shumën e përgjithshme prej 4,182.75€, kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (14.12.2021) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore - përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përpilimin e padisë shumen prej 104.00€, dhe taksën gjyqësore në vlerën prej 20.00 € apo në totalin e përgjithshëm prej 124.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, me datë 14.12.2021 kanë paraqitur padi me objekt kontesti kompensimin e pagave mbi bazën e kualifikimit dhe inflacionit, e drejtë kjo e garantuar me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe

Kontratës Kolektive të datës 22.01.2021, dhe Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008. Po ashtu në precizimin e datës 15.12.2023, ku ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të rregullt pune te e paditura si mësimdhënëse, dhe ka kërkuar që e paditura që në emër të licencimit nga data 01.01.2018 e deri me datë 30.01.2023 për 61 muaj t'ia paguaj shumën prej 3,376.35 €, me diplomë universitare në vlerë të 27% nga paga bazë, në emër të inflacionit për përudhen 01.01.2019 deri 31.10.2022 për 46 muaj t'ia paguaj shumën 806.40 me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi, ka theksuar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa lejuar sepse paditësit nuk kanë ofruar prova se kanë shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative para se ti drejtohen gjykatës me padi, ashtu siç është paraparë me 78 par.1 të Ligjin e Punës. Po ashtu, kompensimet nuk janë paraparë as me Ligj të Punës, ku e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore linja të veçanta buxhetore për këto lloje të kompensimit. Tutje ka shtuar se, kërkesa e paraqitur është parashkruar ashtu si është paraparë me të Ligjit e Marrëdhënieve të Detyrimeve ku parashihet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës me para parashkruhen brenda 3 viteve nga dita e paraqitjes së kërkesës, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, porse e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, kjo vërtetohet edhe nga kontratat e punës së paditëses, e nënshkruar me të paditurën, me anë të së cilës është themeluar marrëdhënia e punës, paditësja në cilësinë e mësimdhënëses-punëmarrëses, ndërsa e paditura si punëdhënëse.

Bazueshmëria e kërkesëpadisë se paditëses ka mbështetje në Vendimin me numër nr.01/33, të datë 29.08.2008, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ashtu që në pikën 3 të këtij Vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm

bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”, ndërsa në pikë 4 thuhet se mësimdhënësit, drejtoret (zëvendësdrejtoret) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me, pika 4.3 “me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagesës bazë prej 27%”, ndërsa në pikën 4.4 përcaktohet se “me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”.

Faktin e lartësisë së pagës për paditësen, gjykata e vërtetoi përmes kontratës së punës dhe listës së pagave të paditëses, ku përcaktohen pagat bazë për paditësen. Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së: Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.

Nga këto pretendime gjykata ka vlerësuar se baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses bazohet në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008, respektivisht pika 4, nga i cili Vendim të paditurës i ka lindur detyrimi për kompensimin e kësaj difference në pagë të palëve paditëse, për më tepër vetë pala e paditur në mënyrë të heshtur e ka paguar pjesërisht këtë detyrim ndaj paditëses, në momentin që e njëjta i ka paguar për çdo muaj paditëses në emër të kualifikimit shumë prej 58.32€.

Po ashtu nga lista e pagave shihet se paditësja në emër të kualifikimit me bachellor, i takon lartësia prej 27%, të pagës bazë, ndërsa i është paguar shuma prej 58,32 €, e që në fakt është dashur të paguhet shuma prej 113,67 €, çka do të thotë se e paditura ka hyrë në detyrim tek paditësi për 61 muaj, apo zbërthyer në vlera monetare shuma prej 55.35 €, për muaj (paga 421 € x 27% = 113.67 €, minus 58.32 €, përfitohet shuma prej 55.35 €, x 61 muaj arrihet shuma prej 3,376.35€).

Ndërsa bazuar në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është paraparë se “Për çdo vite të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë.

Prandaj sa i përket sa i përket pagesës shtesë në emër inflacionit për paditësen gjykata ka gjetur se, shkalla e inflacionit për periudhën kohore 01.01.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7%, andaj ka llogaritur pagën bazë të paditëses (paga 421€ x 2.7% = 11.367€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 136.40€, për periudhën kohore 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2%, andaj ka llogaritur pagën bazë të paditëses (paga 421€ x 0.2% = 0.842€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 10.10€, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4 %, andaj ka llogaritur pagën bazë të paditëses (paga 421€ x 3.4% = 14.31€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma

171.77€, dhe për periudhën kohore 01.01.2022 deri 31.10.2022 ka qenë 11.3%, andaj ka llogaritur pagën bazë të paditëses (paga 421€ x 11.6% = 48.83€) shumëzuar për 10 muaj përfitohet shuma 488.36€.

Andaj bazuar në këto përlllogaritje dhe në dispozitat ligjore, gjykata ka gjetur si tërësisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket lartësisë së saj, andaj dhe i ka njohur këtë të drejtë në kompensim në emër të licencimit dhe inflacionit për paditësen në totalin e shumës si në pikën I të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës në emër të diferencës së papaguar në pagë bazë për licencimit - gradimit, të njëjtit janë legjitimuar që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësja e kanë rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, sepse e paditura nuk e konteston bazën e kërkesës, e as lartësinë e kërkesës së paditëses, me anë të përgjigjes në padi. Ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës, se për këtë objekt të kërkesë e paditura nuk ka planifikuar buxhet dhe nuk kanë vijë buxhetore për ta realizuar këtë kompensim, nuk është rrethanë e natyrës juridike që ndikon për te marr vendim ndryshe në këtë rast. Prandaj gjykata erdhi në përfundim se faktet në këtë rast, nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritator dhe se pala e paditur është obliguar ta përmbush obligimin ndaj paditëses. Ndërsa lidhur me pretendimet se kemi kërkesë të parashkruar të paditëses gjykata këtë pretendim e ka gjetur si të pa bazuar për faktin se në rastin konkret paditësja ka kërkuar realizimin e kësaj të drejte për vitet 2019, 2020 dhe 2021, sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, ndërsa padinë e ka ushtruar në gjykatë në vitin 2021, rrjedhimisht nuk kemi të bëjë me parashkrim pasi që nuk ka kaluar afatit 3 vjeçar.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë datë 14.12.2021.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 124.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 20.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.9344/21, datë 22.01.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.